



AKTI I THEMELIMIT T SHOQERTISE ME PERGJEGJEST TE KUFIZUAR "DIMESIONE TE REJA"

NENT 1

Shoqeria private "DIMESIONE TE REJA" formohet nga themeluesi: Edmond Gjermenit, i biri i Agimit, banues ne lagjen Kongresi i Lushnjes, pallati 157.

NENT 2

Selia e shoqerise eshte ne lagjen Kongresi i Lushnies, pallati 157, Lushnje.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me zahirimin e aktivitetit me miratimin e ortakut te vetem.

NENT 3

Shoqeria ka si objekt veprimtarie: Trejetim artikui te ndryshem industriale, me shumice e pakice, import - eksport.

NENT 4

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me afat mbi 10 vjet te marre si vite kalendarike duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar.

NENT 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Ky kapital eshte teresish i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem.

Shoqeria mund te shtoje ose te pakesoje kapitalin e saj me miratimin nga ortakut themelues.

NENT 6

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku i vetem, organi vendimor.

Shoqeria mund te administrohet nga:

- Nje administrator unik i vetem aktualisht zoti Edmond Gjermenit.

- Nje keshill administrativ.

- Dy administrator me nje firme te perbashket ose te vecante per secilin.

NENT 7

Shtimi i ortakeve:

- Kur ortaku i vetem eshte dakort, qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere, qe keta te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu:
- Se pari meret vendim nga ortaku i vetem, ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.
- Se dyti behet regjistrimi ne librin e ortakut, ku shkruhet emri i plete i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin social.
- Venrimi i bashkimit te ortakut te ri duhet te behet me nje akt material.

TIEMELIEST T SHQERISE

EDMOND GJERMENI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA LUSHNJE

Nr. 162 i Rep.
Nr. 100 i Kol.

Lushnje me 21/1/1997

V E R T E T T M


Sot me daten 21/1/1997, para meje noterit *Adriqan Paroqe* u paraqit personalisht zoti Edmond Gjermenit i biri i Acimit, banues ne Jadjen Kongresi i Lushnjes, Lushnje, i njeftim prej meje noterit me zotesi te plete juridike per te venruar, me identitetin e te cilit u njoba nenermjet leter njoftimit perkates, i cili deklarozi se ka hartuar jashtë kesaj zyre statutin dhe aktin e themelimit te shqerise me perajeariesi te kufizuar "DIMESIONE TE REJA", Lushnje, i cili me vullnetin e tui te lire dhe te pavarur e nenshkruan ate para meje.

Sa me siper vertetohet edhe prej meje noterit.

N O T E R I

Adriqan Paroqe





STATUTI

T SHOQERTISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
DIMESIONE TE REJA

FORMA, RAZA JURIDIKE, SELIA.

NENT 1

Shoqeria private 'DIMESIONE TE REJA' formohet ne
themeluesi: Edmond Gjermani, i birit i Agimit, lindur e banues ne
Lushnje, lagja Kongresi, pallati 157.

NENT 2

Shoqeria eshte person juridik, dhe eshte krijuar ne
perputhje me lejislacionin shqiptar dhe si etille e fillon
aktivitetin me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar.

NENT 3

Selia e shoqerise eshte ne lagjen Kongresi i Lushnjes,
pallati Nr:157, Lushnje.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, me zqjerimin e
aktivitetit, me mireatimin ortakut te vetem.

NENT 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne perputhje me
lejislacionin shqiptar dhe me statusin e saj ne teritorin e
Shqiperise dhe jashte sai.

Shoqeria mund te krijoje filiale ne vende te tjera ne
perputhje me lejislacionin e vendit perkates.

NENT 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar i verballon humbjet
e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te.

LIRRI I SHOQERISE

NENT 6

Per te precizuar e per te saktesuar veprimtarine e vet
ekonomike dhe mardhenjet e punes, shoqeria do te cele librin e
vet, i cili do te quhet liri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

NENT 7

Ortaku vete, dhe per personat e pranuar ne shoqeri, bie dakort qe te mos i ekspozoje asnjë personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat ose ajo do te lidhe, si dhe planet dhe gellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

NENT 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat e tjera qe nxiren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet, si letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme, duhet te tregojne lexueshem emerin e shoqerise dhe pas tij fjalet `` Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar '' ose inicialet `` SHPK '' , kapitalin themeltar dhe emerin e administratorin.

NENT 9

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:
Tregtim artikuj te ndryshem industriale, shumice e pakice, import - eksport.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENT 10

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me afat mbi 10 vjet te marre si vit kalendarik, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar.

KAPITALI THEMELTAR

NENT 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.
Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem.

Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakut thmelues.

NENT 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve (neqofte se do te kete te tille ne te ardhmen), gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen edhe te treteteve me miratimin e ortakut te vetem.

Ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe rruge trashegimie. Transferimet e pjesave dhe kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt notarial.



STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Shoqeria do ta konsideroje qendren e vet ne si shoqeri nene, e cila rast pas rasti do te hapet edhe me filjale te tjera, ose shoqeri te perbashketa ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interes ne permbushjen e gellimit te saj, ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte sai.

NENI 14

Organ i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku i vetem, organi vendimor:

Shoqeria mund te administrohet nga:

- Nje administrator unik, i vetem aktualisht zoti Edmond Gjermenzi.
- Nje keshill administrativ.
- Dy administrator me nje firme te perbashket ose te vecante per secilin.

NENI 15

Administratori ose administratoret neqoftese do te kete, mund te jene ose jo ortake sipas percaktimit te ortakut te vetem.

Administratori shkarkohet me vendim te ortakut ose kur jep vete doreheqjen:

NENI 16

Administratori unik dhe ai i autorizuar, i ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne mardhenje me te trete ne emri te shoqerise dhe ne te gjitha rethanat.

Ai ka te drejte te marre pjesa ne shitie, ne blerje, ne procedurat e falimentimit, te hartoje kontrata te karaktereve te ndryshme, asikuracione, te tjetersoje pasuri te lujteshme dhe te palujteshme, te hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare dhe te huaja si dhe te depoziteje dhe te huaje para, te perfaqsoje shoqeine ne mardhenje me te tretet dhe ne organet gjyqesore dhe administrative etj.

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SIUPERNDARJA DHE LTIKU.IDIMI

NENI 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe keto libra:

- Libri i ortakut ne te cilen shenohet emri i plotë i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit vendimor.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit administrativ.

BILANCI**NENI 18**

Bilanci mbylljet me 31 dhjetor te cdo viti, ku i pari do te jete perjashtrimisht me 31 dhjetor te vitit 1997.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku i vetem miratohet nga ai, miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimitarine vjetore behet brenda nje afati prej kater muajsh nga data e mbylljes se vitit finanziar.

DIVIDENTET**NENI 19**

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidencimit te egzistences se fitimeve, percaktohet pjesa qe i takon ortakut themelues ne formen e dividentit mbi fitimin.

Ky fitim perbehet nga fitimi i vitit finanziar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domozdoshem te percaktuar nga ortaku, te fondeve te tiera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tieter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

**SUPERNDARJA DHE LIKUJDIMIT
I SHOGERISE****NENT 20**

Shoqeria prishet kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyet te parashikuara ne ligj.

NENT 21

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaku cakton nje ose disa likujdues te cilet i paragesin asj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit ortaku vendos mbi bilancin perfundimtar finanziar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjesave te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates(nese ka te tille), likujduesi ndan kapitalin per ortakun themelues.

MARDHENJET PER PUNESIM**NENT 22**

Kriteret e pergitheshme te punesimit te personave te tjere, numerin e tyre kufijte e pageses, dhe detyrat e se cilite ne shoqeri percaktohet nga ortaku i vetem.

Punesimi i personave ne shoqeri kruhet mbi bazen e kontrates individuale te punes te hartuar sipas legjpcionit shqiptar ne fuqi.

NENT 23

Shoqeria mer persiper te respekoje rregullat ne fugi punesimit dhe te sigurimeve shogerore per te gjithe te punesuarit ne te ndersa keta te fundit duhet te pranojne kete statut.

Te punesuarit pergjigjen simbas ligjit dhe sipas ketij statuti per mos zbatimin e detyrate dhe demeve qe ata i shkatoine shogerise.

NENT 24

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate egzistences se shogerise, ose gjate periudhes se likujdimit, qe mund te lindin midis shogerise dhe te treteve do te tentohet te zajidheen me mirekuptim, ne te kundert do ti paragiten per zajidhje gjykates kopetente shqiptare konforme legjisacionit shqiptar.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENT 25

Shtimi i ortakeve :

Kur ortaku i vetem eshte dakort qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere, qe keta te fundit te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu:

- Se pari merret vendim nga ortaku i vetem, ku shavrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.

- Se dyti behet regjistrimi ne librin e ortakut, ku shkruhet emri i plotë i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin social.

- Veprimi i bashkimit te ortakut te ri duhet te behet me nje akt notarial.

NENT 26

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve te metejshme me ane amedamentesh sa here qe e sheh te arsyeshme ortaku themelues i kesaj shoqerie.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behet ne te njejtene menyre dhe procedure me te cilen behet vete nxjerrjka e ketij statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shogerise.

Ky statut eshte hartuar ne pese kopje shqip dhe pasi lexohet dhe gjendet sipas vullnetit te pales nenshkruehet prej tij rregullisht.

ORTAKU I VETEM

EDMOND GJERMENI

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Edmond Gjermen". The signature is fluid and cursive, with a prominent "G" at the beginning.